



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A NR.99/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Ymer Hoxha, anëtarë, përkritazi me ankesën e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të KQZ-së, në seancën e mbajtur më 23.02.2010, mori:

VENDIM

Ankesa pranohet si e bazuar.

Kandidati i Pavarur Hasan Bilalli është dënuar me gjobë prej 200 (dyqind) euro. Këtë shumë i është detyruar që të paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur vendimi bëhet i plotfuqishëm, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIMI

KZAP më 25 janar 2010 ka pranuar një ankesë nga ZRPPC të KQZ-së në të cilën pohohet se Kandidati i Pavarur, Hasan Bilalli, nuk e ka dorëzuar Raportin e Deklarimit Financiar në këtë institucion, i cili kërkohet në bazë të Nenit 40.5 dhe 119.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në bazë të nenit 6.6 të Rregullës Zgjedhore nr.12/2009.

Parashtruesi i ankesës vërteton se Kandidati i Pavarur, Hasan Bilalli, nuk e ka sjell Raportin Financiar, që ka qenë deri më 31 Dhjetor 2009 për Raundin e parë (I).

FAKTET

Më 15 Shkurt 2010, KZAP-i, i ka dërguar Kandidatit të Pavarur, Hasan Bilalli një kopje të ankesës së ZRPPC-së dhe i ka ofruar mundësi që të përgjigjet deri më 18.02.2010, në përfundim të orarit të punës së KZAP-it. Sekretariati i KZAP-it nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga Kandidati i Pavarur Hasan Bilalli, deri në kohën e caktuar.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Neni 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

Në këtë kontekst, Kandidati i Pavarur, Hasan Bilalli ka qenë i detyruar në bazë të këtij ligji që të dërgoj Raportin Financiar për Raundin e Parë (I), jo më vonë se 31 Dhjetor 2009 – gjë që nuk ka ndodhur, prandaj pretendimet ankimore janë të bazuara.

Neni 120.1, pika c) - (Përmirësimet dhe sanksionet nda shkeljeve) të LZP-së, përcakton se: në rast se KZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e Rregullave Zgjedhore të KQZ-së mund të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik ose një organizatë vëzhguese në një vlerë deri në dyqindmijë euro (200,000 €).

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjobitjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, KZAP -i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse kandidati i pavarur ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi;
- Masat, nëse ka pasur raste të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga kandidati i pavarur për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore të tij;
- Ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese ose rënduese.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 99/2010 më datën 23.02.2010



Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

